



BULETINI JAVOR I VEPRIMTARISË SË KUVENDIT

Nr. 5, 09-15.11.2020

Këtë javë në komisionet parlamentare

■ U shqyrtuan 6 projektligje dhe 1 Akt Normativ i rëndësishëm:

• Projektligjet:

- “Për buxhetin e vitit 2021”;
- “Për miratimin e Buxhetit Faktik 2019”
- “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për projektin bashki të forta”;
- “Për Censin e popullsisë dhe të banesave”;
- “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.74/2014 “Për armët”
- “Për prokurimin publik”

• **Aktin Normativ** nr. 32, datë 12.10.2020 “Për një ndryshim në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar”.

■ U zhvillua një seancë dëgjimore

Në drejtimin e kryetarit z. Enver Roshi Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë zhvilloi një seancë dëgjimore publike me prindërit e fëmijëve me çrregullime të spektrit autik. Të pranishme në mbledhje ishin znj. Vasilika Hysi, zëvendëskryetare e Kuvendit, znj. Bardhylka Kospiri zëvendësministre në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale etj. Znj Hysi në fjalën e saj, në emër edhe të kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, shprehu angazhimin e saj edhe si deputete për adresimin e problematikave të ngritura, për të bërë më të mirën për fëmijët dhe familjet e tyre. Prindërit e fëmijëve me çrregullime të spektrit autik diskutuan lidhur me nevojën e adresimit dhe zgjidhjes të problemeve të fëmijëve autikë dhe cekën një sërë problematikash që kanë të bëjnë me arsimin profesional, trajtimin ekonomik të tyre, kujdestarinë etj

Këtë javë në komisionet parlamentare

■ Projekt-buxheti 2021

- **Komisioni për Ekonominë dhe Financat** zhvilloi seanca dëgjimore me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; ministrin e Shtetit për Rindërtim, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; përfaqësues nga Pushteti Vendor.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021” dhe ia kaloi për miratim seancës plenare.

- **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut** zhvilloi seanca dëgjimore me Presidencën, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, KQZ, Avokatin e Popullit, Shoqatën e Bashkive, institucionet kushtetuese të krijuara me ligj, etj dhe miratoi në tërësi projekt- buxhetin e vitit 2021.

- **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin**, miratoi në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”.

- **Komisioni për Sigurinë Kombëtare** miratoi në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”

-**Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik** zhvilloi seanca dëgjimore me përfaqësues të grupeve të interesit dhe miratoi në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”.

- **Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë** miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin "Për buxhetin e vitit 2021”.

- **Komisioni për Integrimin Europian** miratoi në tërësi projekt-buxhetin e vitit 2021 për Ministrinë e Evropës dhe Punët e Jashtme.

Aktivite parlamentare

■ 1-vjetori i krijimit të Parlamentit të Nxënësve: Veprimtari në Kuvendin e Shqipërisë

9 nëntor 2020- Me rastin e 1-vjetorit të krijimit të Parlamentit të Nxënësve, në sallën e seancës plenare u zhvillua takim i nxënësve, pjesë e rrjetit të këtij parlamenti. Në takim mori pjesë Zëvendëskryetarja e Kuvendit, znj. Vasilika Hysi dhe Ministrija e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Evis Kushi.

Në takim u diskutuan çështje aktuale e jetike të nxënësve të shkollave të mesme: mbarëvajtja e mësimit online, mbrojtja e fëmijëve nga pandemia Covid-19, lufta kundër shfaqjeve të bullizmit, etj., si dhe u prezantuan disa nisma e projekt-ide të veçanta si “Digjitalizo 1 Nxënës”, “Panairi i punës online”, nisma “Pastro Qytetin Tënd”, “Parandalimi i Bullizmit për Shkak të Prekjes nga Covid-19”, projekti “Informatikanët e Rinj” dhe projekti “Katalogu për Universitetin”.

■ Kryesia e komisionit parlamentar për Shëndetësinë priti në takim Drejtorin e OBSH-së për Evropën

12 nëntor 2020- Kryesia e komisionit parlamentar për shëndetësinë, kryetari Enver Roshi dhe zëvendëskryetarja Klodiana Spahiu, pritën në takim drejtorin e OBSH-së për Evropën, z. Hans Kluge dhe znj. Bettina Menne, shefe e OBSH-së për Shqipërinë. Z. Roshi prezantoi për z. Kluge arritjet dhe përpjekjet e komisionit parlamentar në drejtim të mbështetjes parlamentare të institucioneve dhe stafeve shëndetësore gjatë periudhës pandemike. Gjithashtu, z. Roshi paraqiti edhe një tablo tërësore të situatës politike dhe shëndetësore në vend. Si një profesionist i shëndetit publik, ai listoi edhe disa arritje të fushës në krahasim me të shkuarën, në këtë pike u mbështet edhe nga znj. Spahiu.

■ Përfundon Shkolla e Integrit Evropian 2020

13 nëntor 2020- Përfundon edicioni i pestë i Shkollës së Integrit Evropian 2020, pas dy javësh trajnimi intensiv dhe të suksesshëm të organizuar online. Shkolla organizohet nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Integrit Evropian me mbështetjen e Deleghacionit të BE në Tiranë, Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung..

Aktivite të Kryetarit të Kuvendit

- **Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, uron Marshallen e Sejmit të Polonisë Witek, me rastin e Ditës së Pavarësisë: Polonia, partnere në NATO dhe mbështetje e fuqishme e integritit evropian të Shqipërisë**

11 nëntor 2020 - Me rastin e Ditës së Pavarësisë Kombëtare, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i ka dërguar një letër urimi Marshalles së Sejmit të Polonisë, Elzbieta Witek. “Themelimi, 102 vjet më parë, i Republikës së Dytë të dhe e saj nga perandoritë e kohës është një ngjarje historike për Poloninë si edhe për të ardhmen e popullit mik polak. Gjatë më se një shekulli, Polonia është zhvilluar e konsoliduar si një vend i rëndësishëm dhe i fuqishëm, ka kaluar prova të mëdha dhe është përfshirë në valët e demokratizimit si një shoqëri e emancipuar dhe e suksesshme. Gjatë tre dekadave të fundit, arritjet në zhvillimin ekonomik, rritjen e mirëqenies së popullit polak dhe konsolidimin e demokracisë janë të dukshme dhe një model edhe për vendet e tjera që i bashkohen familjes europiane. Shqipëria e konsideron Poloninë një vend të afërt e mik, partner të ngushtë në NATO dhe mbështetje të fuqishme për integritin evropian të vendit. Vendimi i marrë nga Këshilli i Bashkimit European në datën 25 mars 2020 për hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë, i bazuar në progresin e arritur në reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara nga Këshilli, është rezultat edhe i kontributit të vazhdueshëm dhe mbështetjes së fuqishme të Polonisë, Sejmit dhe Tuajës personalisht.”, shkruan në letrën e tij të urimit Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

